

KONVENTE E BAZELIT MBI KONTROLLIN E  
LEVIZJEVE NDËRKUFITARE TË MBETJEVE TË RREZIKSHME  
DHE ASGJESIMIN E TYRE  
PËRSHTATUR NGA KONFERENCA E  
PLENIPOTENIARES NE 22 MARS 1989

Hyre ne fuqi  
5 MAJ 1992

68 PALË KONTRAKTUESE  
NE QERSHOR 1994

## HYRJE

Palët e kësaj Konvente,

të ndërgjegjshëm për rrezikun e dëmtimit të shëndetit të njeriut dhe mjedisit të shkaktuar prej mbetjeve të rrezikshme (M.R.) dhe mbetjeve të tjera dhe lëvizjes së tyre ndërkufitare.

të kujdesshëm ndaj rrezikut në rritje për shëndetin e njeriut dhe mjedisin të shkaktuar nga prodhimi i rritur dhe lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.

të kujdesshëm gjithashtu ndaj faktit së mënyra më efektive për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga rreziqet e shkaktuara prej mbetjeve të tilla është pakësimi në minimum i prodhimit të tyre përta i përket sasisë dhe potencialit të rrezikshmërisë.

të bindur që shtetet duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që trajtimi i (M.Rr.) dhe mbetjeve të tjera duke përfshirë lëvizjen ndërkufitare dhe asgjësimin e tyre, është në përputhje me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, cilido qoftë vendi i asgjësimit.

duke vërejtur që shtetet do të japin siguri që (prodhuesi) do të kryejë detyrimet përta i përket transportit dhe asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera në një mënyrë që është në përputhje me mbrojtjen e mjedisit cilido qoftë vendi i asgjësimit.

duke ditur plotësisht që çdo shtet ka të drejtën sovrae të ndalojë hyrjen ose asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme të huaja ose mbetjeve të tjera në territorin e tij.

duke njohur gjithashtu dëshirën në rritje për ndalimin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimit të tyre në vende të tjera, sidomos në vendet në zhvillim.

të bindur që mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera duhet, sa kohë që janë në pajtim me një administrim të duhur dhe efikas mjedisor, të asgjësohen në shtetin ku janë prodhuar.

**të ndërgjegjshëm gjithashtu** që lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të tilla nga shteti prodhues i tyre në ndonjë shtet tjetër duhet të lejohen vetëm kur ato trajtohen sipas kushteve që nuk rrezikojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe sipas kushteve në përputhje me klauzolat e kësaj konvente.

duke shqyrtuar se kontrolli në rritje i lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera do të veprojë si një nxitës për trajtimin e tyre të plotë në përputhje me mjedisin dhe për pakësimin e volumit të kësaj lëvizjeje.

të bindur që shtetet duhet të marrin masa për shkëmbimin e duhur të informacionit dhe kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera nga dhe për në këto shtete.

duke vërejtur që një sërë marrëveshesh ndërkombëtare dhe rajonale e trajtojnë çështjen e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, në lidhje me kalimin tranzit të mallrave të rrezikshme.

duke marrë parasysh Deklaratën e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor (1972 Stokholm), udhëzimet e Kajros dhe parimet për Trajtimin e Plotë nga ana mjedisore të mbetjeve të rrezikshme, e miratur nga Këshilli Qeverisës i UNEP-it me vendim 14/90 të 17 Qershorit 1987, Rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara për transportimin e mallrave të rrezikshme (e formuluar më 1957 dhe riazhornuar çdo dy vjet) rekomandimet përkatëse, deklaratat, dokumentat dhe rregullat përkatëse të miratuara brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe punës e studimeve të bëra brenda organizatave të tjera rajonale e ndërkombëtare.

të kujdesshëm ndaj frymës, parimeve, qëllimeve dhe funksioneve të Kartës së Kombeve të Bashkuara për Natyrën të miratur nga Asambleja e Përgjithshme në sesionin e saj të 37<sup>te</sup> (1982), si rregull i etikës në lidhje me mbrojtjen e mjedisit njerezor dhe konservimit të burimeve natyrore.

duke pohuar që shtetet janë përgjegjës për realizimin e detyrimeve ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe janë përgjegjës sipas ligjit ndërkombëtar.

duke ditur që në rast të një shkelje materiale të klauzolave të kësaj Konvente ose të çdo protokollit do të zbatohet ligji përkatës ndërkombëtar mbi traktatet.

të ndërgjegjshëm për nevojën e vazhdimit të zhvillimit dhe zbatimit të teknologjive me mbetje të pakta dhe që nuk dëmtojnë mjedisin, të alternativave riqarkulluese, të sistemeve të mira administrimi dhe drejtimi, me qëllim që të pakësohet në minimum prodhimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.

të ndërgjegjshëm gjithashtu për shqetësimin ndërkombëtar në rritje lidhur me nevojat për një kontroll të fortë të lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, dhe të nevojës për të reduktuar sa të jetë e mundur në minimum një lëvizje të tillë.

të shqetësuar për problemin e trafikut ilegal ndërkufitar të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.

duke marrë gjithashtu parasysh aftësitë e kufizuara të vendeve në zhvillim për të trajtuar mbetjet e rrezikshme dhe mbetje të tjera.

duke ditur nevojën për nxitjen e transferimit të teknologjise për të trajtuar në mënyrë të sigurt mbetjet e rrezikshme dhe mbetje të tjera të prodhuara lokalisht, veçanërisht në vendet në zhvillim në përputhje me frymën e udhëzimeve të Kajros dhe vendimit 14/16 të Këshillit Qeverisës të UNEP-it mbi nxitjen e transferimit të teknologjisë së mbrojtjes së mjedisit.

duke ditur gjithashtu që mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera duhen transportuar

në përputhje me konventat dhe rekomandimet përkatëse ndërkombëtare.

*të bindur që* lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera duhet lejuar vetëm kur transporti dhe asgjësimi përfundimtar i mbeturinave të tilla nuk cenon mjedisin dhe

*të vendosur* të mbrojnë, me anë të një kontrolli të rreptë, shëndetin e njeriut dhe mjedisin kundër efekteve negative që mund të rrjedhin nga prodhimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.

## KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË

### Neni 1 SFERA E VEPRIMTARISË SË KONVENTËS

1. Mbetjet e mëposhtme që i nënshtrohen lëvizjes ndërkufitare do të jenë "mbetje të rrezikshme" për qëllimet e kësaj konvente :

(a) mbetjet që i përkasin çdo kategorie që përmban Shtojca 1, në qoftë se ato posedojne ndonjë prej karakteristikave që përmban Shtojca 3, dhe

(b) Mbetjet që nuk mbulohen nga paragrafi (a) por që përcaktohen si, ose konsiderohen të jenë mbetje të rrezikshme nga legjislacioni vendas i Palës së eksportit, importit ose tranzitit.

2. Mbetjet që i përkasin çdo kategorie që përmban Shtojca 2 dhe që i nënshtrohen lëvizjes ndërkufitare do të jenë "mbetje të tjera" për qëllimet e kësaj konvente.

3. Mbetjet që si rezultat i të qenit radioaktive i nënshtrohen sistemeve të tjera ndërkombëtare të kontrollit duke përfshirë dokumentet ndërkombëtare që iu referohen specifikisht materialeve radioaktive përjashtohen nga sfera e veprimit të kësaj konvente.

4. Mbetjet që rrjedhin prej operacioneve normale të një anije, shkarkimi i së cilave mbulohet nga një dokument tjetër ndërkombëtar përjashtohen nga sfera e veprimit të kësaj Konvente.

### Neni 2 PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj Konvente :

1. "Mbetjet" janë substanca ose objekte që asgjesohen ose destinohen të asgjesohen ose që kërkohen të asgjesohen sikurse parashikon ligji kombëtar.

2. "Trajtimi" d.mth mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, duke përfshirë këtu edhe kujdesin e mëvonshëm të vendeve të asgjësimit.

3. "Lëvizja ndërkufitare" do të thotë çdo lëvizje e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera nga një zonë nën juridiksionin kombëtar të një shteti ose nëpërmjet një zone nën juridiksionin kombëtar të një shteti tjetër ose/dhe nëpërmjet një zone që nuk është nën juridiksionin e ndonjë shteti me kusht që të paktën dy shtete të përfshihen në lëvizje.
4. "Asgjesimi" do të thote çdo operacion i specifikuar në shtojcën 4 të kësaj Konvente.
5. "Vendi ose paisjet e aprovuara" do të thotë vendi ose paisjet për asgjesimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera, i cili është i autorizuar ose lejohet të përdoret për këtë qëllim nga autoriteti përkatës i shtetit ku janë lokalizuar vendi ose paisjet.
6. "Autoritet kompetent" do të thotë çdo autoritet qeveritar i zgjedhur nga një Palë për të qënë përgjegjës, brenda zonave të tilla gjeografike që Pala i mendon të përshtatshëm për marrjen e njoftimit të një lëvizje ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera dhe për çdo informacion që ka lidhje me të dhe për përgjigjen ndaj njoftimit të tillë, siç jepet në nenin 6.
7. "Pikë fokale" do të thote qënësia e një Pale, sipas nenit 5, përgjegjëse për marrjen dhe prezantimin e informacionit sipas nenit 13 dhe 15
8. "Administrim i duhur nga ana mjedisore i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera" d.m.th. marrja e të gjitha hapave praktikë për të siguruar që mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet tjera administrohen në një mënyrë që mbron shëndetin e njeriut dhe mjedisit ndaj efekteve negative që rrjedhin prej mbetjeve të tilla.
9. "Zonë në juridiksionin kombëtar të një shteti " d.m.th. çdo tokë, zonë detare ose hapësirë ajrore brenda së cilës një shtet ushtron përgjegjësi administrative dhe rregullatore në përputhje me ligjin ndërkombëtar, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.
10. "Shteti i eksportit" d.m.th. një Palë prej së cilës planifikohet të fillojë ose fillohet një lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.
11. "Shteti i importit" d.m.th. një Palë në drejtim të së cilës planifikohet ose ndodh një lëvizje ndërkufitare për qëllim asgjesimi në të ose qëllim shkarkimi para asgjesimit në një zonë që nuk është nën juridiksionin kombëtar të ndonjë shteti.
12. "Shteti i tranzitit" d.m.th. çdo shtet, përveç atij të eksportit dhe importit, nëpërmjet të cilit planifikohet ose ndodh një lëvizje e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera.
13. "Shtetet e interesuara" d.m.th. Palët që janë shtetet e eksportit, importit ose tranzitit Palë ose Jo Palë.
14. "Person" d.m.th. çdo person nën juridiksionin e shtetit të eksportit i cili bën përgatitjet për eksportimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera.

15. "Eksportues" d.m.th. çdo person nën juridiksionin e shtetit të eksportit i cili bën përgatitjet për eksportimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera.
16. "Importuesi" d.m.th. çdo person nën juridiksionin e shtetit të importit i cili bën përgatitjet për importimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera.
17. "Transportues" d.m.th. çdo person që kryen transportin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera.
18. "Prodhues" d.m.th. çdo person aktiviteti i të cilit prodhon mbetje të rrezikshme ose mbetje të tjera ose në qoftë se ky person nuk është i njohur, personi që i zotëron dhe i ka nën kontroll këto mbetje.
19. "Asgjesues" d.m.th. çdo person drejt të cilit mbetjet e rrezikshme transformohen dhe kryen asgjesimin e mbetjeve të tilla.
20. "Organizatë e integritit ekonomik dhe politike" d.m.th. një organizatë që përbëhet nga shtetet sovraane të cilave shtetet anëtare i kanë dhënë kompetencat në lidhje me çështjet e udhëhequra nga kjo Konventë dhe e cila është plotësisht e autorizuar në përputhje me procedurat e saj të brendshme të nënshkruajë, ratifikojë, pranojë, aprovojë dhe formalisht konfirmojë ose të pajtohet me të.
21. "Trafik ilegal" d.m.th. çdo lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme ose e mbetjeve të tjera siç specifikohet në nenin 9.

### Neni 3

#### PËRKUFIZIMET KOMBËTARE TË MBETJEVE TË RREZIKSHME

1. Çdo Palë, brenda 6 muajve që bëhet Palë në këtë Konventë do të informojë Sekretarin e Konventës për Mbetjet, përveç atyre në listën e Shtojces 1 dhe 2 dhe që konsiderohen ose përcaktohen si të rrezikshme sipas legjislacionit të vet kombëtar dhe për çdo kërkesë në lidhje me procedurat e lëvizjes ndërkufitare të zbatueshme për mbetje të tilla.
2. Çdo palë më vonë do të informojë Sekretariatit për ndonjë ndryshim të rëndësishëm në lidhje me informacionin e dhënë në paragrafin 1.
3. Sekretariati do të informojë menjëherë të gjitha Palët mbi informacionin që ajo ka marrë sipas paragrafit 1 dhe 2.
4. Palët do të jenë përgjegjëse për vënien e informacionit të dhënë Sekretariatit sipas paragrafit 3, në dispozicion të eksportuesve të tyre.

### Neni 4

#### DETYRIME TË PËRGJITHSHME

1. (a) Palët që ushtrojnë të drejtën e tyre për të ndaluar importimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera për asgjesim, do të informojnë Palët e tjera për vendimet e tyre në përputhje me Nenin 13.

(b) Palët do të ndalojnë ose nuk do të lejojnë eksportimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera, Palëve që e kanë ndaluar importimin e mbetjeve të tilla kur njoftohen në përputhje me paragrafin (a) me sipër.

(c) Palët do të ndalojnë ose nuk do të lejojnë eksportimin e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera në qoftë se shteti i importit nuk është dakord me shkrim për importimin specifik, në rastin kur shteti i importit nuk e ka ndaluar importimin e mbetjeve të tilla.

2. Secila palë do të marrë masat e duhura :

(a) për të siguruar që prodhimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, brenda saj i është pakësuar në minimum duke marrë parasysh aspektet sociale, teknologjike dhe ekonomike.

(b) për të siguruar pajisjet e përshtatshme të asgjësimit për një trajtim të plotë nga ana mjedisore të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera që do të lokalizohen në shkallë të mundur brenda saj, cilido qoftë vendi i asgjësimit të tyre.

(c) për të siguruar që personat e angazhuar në drejtimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera brenda saj do të marrin masa të tilla të domosdoshme për ndalimin e ndotjes si rezultat i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera që lindin nga ky trajtim dhe në qoftë se një ndotje e tille ndodh të minimizojë pasojat për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

(d) për të siguruar që lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera është pakësuar në minimum në përputhje me trajtimin efikas e të plotë nga ana mjedisore e mbetjeve të tilla dhe kryhet në një mënyrë që do të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin ndaj efekteve negative që rrjedhin nga një lëvizje e tillë.

(e) për të mos lejuar eksportin e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të një shteti ose grup shtetesh që i përkasin një organizate të integritit politik-ekonomik palë të së cilës janë, veçanërisht në vendet në zhvillim, të cilat kanë ndaluar me ligj të gjitha importet, ose në qoftë se ka arsye të bëhet që mbetjet në fjalë nuk do të trajtohen në një mënyrë të duhur nga ana mjedisore, sipas kriterëve që do të vendosen nga Palët në mbledhjen e tyre të parë.

(f) për të kërkuar që informacioni rreth një lëvizjeje të propozuar ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera t'u jepet shteteve të interesuar sipas Shtojcës V.A, për të shprehur qartë efektet e lëvizjes së propozuar mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisit.

(g) për të ndaluar importimin e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera në qoftë se ka arsye të besohet që mbetjet në fjalë nuk do të trajtohen në një mënyrë të shëndoshë nga ana mjedisore.

(h) për të bashkëpunuar në aktivitetet me Palët e tjera dhe organizatat e interesuara, direkt ose përmes Sekretariatit duke përfshirë përhapjen e informacionit mbi lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera, me qëllim që të përmirësojë trajtimin e plotë mjedisor të mbetjeve të tilla dhe për të arritur

ndalimin e trafikut ilegal.

3. Palët mendojnë që trafiku ilegal i mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera është krim.

4. Çdo Palë do të marrë masat e duhura ligjore, administrative dhe masa të tjera për zbatimin dhe mbeshtetjen e vendimeve të kësaj Konvente, duke përfshirë masat për ndalimin dhe dënimin e trajtimit në kundërshtim me Konventën.

5. Një Palë nuk do të lejojë që mbetjet e rrezikshme ose mbetjet e tjera t'i eksportohen një vendi që nuk është Palë (Jo Palë) ose t'u importohen nga një Jo Palë.

6. Palët bien dakord për të mos lejuar eksportin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera për asgjësimin brenda një zone Jug 6<sup>o</sup> gjerësi jugore, në se keto mbetje i nënshtrohen një lëvizje ndërkufitare ose jo.

7. *Përveç kësaj, çdo Palë :*

(a) do të ndalojë të gjithë personat në bazë të juridiksionit të saj kombëtar të transportojnë ose asgjesojnë mbetje të rrezikshme ose mbetje të tjera në qoftë se këta persona nuk janë autorizuar ose lejuar të kryejnë këto lloje operacionesh.

(b) do të kërkojë që mbetjet e rrezikshme ose mbetje të tjera që do t'i nënshtrohen lëvizjes ndërkufitare të paketohen, emërtohen dhe transportohen në përputhje me rregullat dhe standartet ndërkombëtare të pranuar dhe njohura botërisht në fushën e paketimit, emërimit dhe transportit dhe do të kërkojë që të mbahen mirë parasysh praktikat e njohura ndërkombëtare që kanë lidhje me të.

(c) do të kërkojë që mbetjet e rrezikshme ose mbetje të tjera që do të eksportohen, trajtohen në një mënyrë të plotë nga ana mjedisore në shtetin e importit ose gjetkë, udhëzimet teknike për mbetjet që i nënshtrohen kësaj Konvente do të vendosen nga Palët në mbledhjen e tyre të parë.

9. Palët do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera mund të lejohet vetëm në qoftë se:

(a) Shteti i eksportit nuk ka kapacitetin teknik dhe pajisjet e nevojshme, kapacitetin ose vendet e përshtatshme për asgjesimet me qëllim që të asgjesojë mbetjet në fjalë me një mënyrë efikase e të plotë nga ana mjedisore; ose

(b) Mbetjet në fjalë kërkohen si lëndë e parë për riqarkullimin **ose** industrinë e rikuperuara në shtetin e importit, ose

(c) Lëvizja ndërkufitare në fjalë është në përputhje me kriteret e tjera që do të vendosen nga Palët, me kusht që këto kritere nuk ndryshojnë prej objektivave të kësaj Konvente.

10. Detyrimi sipas kësaj Konvente të shteteve sipas së cilës mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera prodhohen, për të kërkuar që këto mbetje të trajtohen në një mënyrë të plotë nga ana mjedisore, nuk mund të transferohen në asnjë rrethane tek shtetet e importit ose tranzitit.



11. Asgjë në këtë Konventë nuk do të pengojë një Palë që të imponojë kërkesa të tjera që janë në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente dhe në pajtim me rregullat e ligjit ndërkombëtar me qëllim që të mbrojnë më mirë shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

12. Asgjë në këtë Konventë në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë mbi sovranitetin e shteteve mbi ujrat e tyre territoriale të vendosura në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe mbi të drejtat sovraane dhe juridiksionin që kanë shtetet në zonat e tyre ekonomike ekskluzive dhe në sheshinat kontinentale në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe ushtrimin të të drejtave përkatëse të lundrimit të anijeve dhe avioneve të të gjitha shteteve si edhe të lirive të parashikuar në ligjin ndërkombëtar dhe të pasqyruar në dokumentat përkatëse ndërkombëtare.

13. Palët do të ndërmarrin shqyrtimin periodik të mundësive të pakësimit të sasisë ose potencialit të ndotjes prej mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të cilat eksportohen në shtete të tjera veçanërisht në vendet në zhvillim.

#### Neni 5

### EMËRIMI I AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE PIKËS FOKALE

Për lehtësimin e zbatimit të kësaj Konvente, Palët :

1. Do të emërojnë ose caktojnë një ose më shumë autoritete kompetente, dhe 1 pike fokale. Një autoritet kompetent do të emërohet për të marrë njoftim në rastin e një shteti tranzit.

2. Do të informojnë Sekretariatin brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Konventës për ta, se çfare agjensish kanë emëruar ata si pikë fokale dhe autoritetet e tyre kompetente.

3. Do të informojnë Sekretariatin brenda një muaji nga data e vendimit rreth ndonjë ndryshimi përsa i përket emërimit të bërë prej tyre sipas paragrafit 2 më sipër :

#### Neni 6

### LËVIZJA NDËRKUFITARE MIDIS PALËVE

1. Shteti i eksportit do të njoftojë dhe do t'i kërkojë prodhuesit ose eksportuesit të njoftojë me shkrim, përmes kanalit të autoritetit kompetent të shtetit të eksportit, autoritetin kompetent të shteteve të interesuara rreth çdo lëvizjeje të propozuar ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera. Një njoftim i tillë do të përmbajë deklaratat dhe informacionin e specifikuar në shtojcën 5A, të shkruar në gjuhë të pranueshme për shtetin e importit. Vetëm një njoftim nevojitet t'i dërgohet secilit shtet të interesuar.

2. Shteti i importit do t'i përgjigjet njoftuesit me shkrim, duke dhënë pëlqimin për lëvizjen me ose pa kushte duke mohuar lejimin e lëvizjes ose duke kërkuar informacionin shtesë. Një kopje përgjigjes përfundimtare të shtetit të importit do t'i dërgohet autoriteteve kompetente të shteteve të interesuara të cilat janë Palë.

3. Shteti i eksportit nuk do të lejojë prodhuesin ose eksportuesin të fillojë lëvizjen ndërkufitare derisa ai të marrë konfirmim me shkrim që :

(a) njoftuesi ka marrë pëlqimin me shkrim të shtetit të importit, dhe

(b) njoftuesi ka marrë prej shtetit të importit konfirmim mbi ekzistencën e një kontrate midis eksportuesit dhe asgjësuesit, duke specifikuar trajtimin e plotë nga ana mjedisore të mbetjeve në fjalë.

4. Çdo shtet i tranzitit që është Palë do t'i vërtetojë menjëherë njoftuesit marrjen e njoftimit. Ai mund të përgjigjet më vonë njoftuesit me shkrim brenda 60 ditësh duke dhënë pëlqimin për lëvizjen me ose pa kushte duke mohuar lejimin e lëvizjes ose duke kërkuar informacion suplementar. Shteti i eksportit nuk do të lejojë fillimin e lëvizjes ndërkufitare derisa ai të ketë marrë miratimin me shkrim prej shteteve të tranzitit. Megjithatë, në qoftë se ndonjëherë një Palë vendos që të mos kërkojë miratim paraprak me shkrim, qoftë në përgjithësi qoftë sipas kushteve specifike për lëvizjet tranzite ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera ose modifikon kërkesat e tij në këtë aspekt, do të informojë menjëherë Palët e tjera për vendimin e saj në pajtim me nenin 13. Në rastin e fundit, në qoftë se nuk merret asnjë përgjigje nga shteti i eksportit brenda 60 ditëve nga marrja e një njoftimi të dhënë prej shtetit të tranzitit, shteti i eksportit mund të lejojë eksportin të kalojë përmes shtetit të tranzitit.

5. Në rastin e një lëvizje ndërkufitare të mbetjeve, kur ato janë ligjërisht të përcaktuara si ose konsiderohen të jenë mbetje të rrezikshme vetëm :

(a) prej shtetit të eksportit, kërkesat e paragrafit 9 të këtij neni që i referohen importuesit ose asgjësuesit dhe shteti i importit do të drejtohen me ndryshimet përkatëse eksportuesit dhe shtetit të eksportit respektivisht.

(b) prej shtetit të importit ose prej shteteve të importit dhe tranzitit ku janë Palë, kërkesat e paragrafëve 1, 3, 4 dhe 6 të këtij neni që i drejtohen eksportuesit dhe shtetit të eksportit do t'i drejtohen me ndryshimet përkatëse importuesit ose asgjësuesit dhe shteteve të importit, respektivisht, ose

(c) prej çdo shteti të tranzitit i cili është Palë, klauzolat e paragrafit 4 do t'i referohen një shteti të tillë.

6. Shteti i eksportit, i kushtëzuar nga miratimi me shkrim i shteteve të interesuara, mund të lejojë prodhuesin ose eksportuesin të përdoret një njoftim të përgjithshëm, ku mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera që kanë të njëjtat karakteristika fizike dhe kimike të transportohen (me anije) rregullisht të njëjtë asgjësues, përmes së njëjtës doganë të daljes të shtetit të eksportit përmes të njëjtës doganë të hyrjes të shtetit të importit, dhe në rastin e tranzitit përmes së njëjtës doganë të hyrjes, daljes të shtetit ose shteteve të tranzitit.

7. Shtetet e interesuara mund të bëjnë miratimin e tyre me shkrim për përdorimin e njoftimit të përgjithshëm që i referohet paragrafit 6, i kushtëzuar nga pajisja me informacion të caktuar të tillë, si sasi të, ekzakte ose listat periodike të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera që do të transportohen (me anije).

8. Njoftimi i përgjithshëm dhe miratimi me shkrim që i referohet paragrafëve 6 dhe 7 mund të mbulojë transportime të shumëfishta të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera gjatë një periudhe maksimale prej 12 muajsh.

9. Palët do të kërkojnë që çdo person që merr përgjegjësinë për lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, të firmosë dokumentin e lëvizjes ose për dërgimin, ose për marrjen e mbetjeve në fjalë. Ato gjithashtu do të kërkojnë që asgjesuesi të informojë eksportuesit dhe autoritetin kompetent të shtetit të eksportit, për marrjen nga ana e asgjesuesit e mbetjeve në fjalë dhe në kohën e duhur për kryejën e asgjesimit siç specifikohet në njoftim. Në qoftë se një informacion i tillë nuk merret brenda shtetit të eksportit, autoriteti kompetent i shtetit të eksportit ose eksportuesit do të njoftojnë kështu shtetin importues.

10. Njoftimi dhe përgjigja e kërkuar në këtë nen, do t'i transmetohet autoritetit të Palëve të interesuara ose autoriteteve të tilla qeveritare që mund të jenë të përshtatshme në rastin e Jo Palëve.

11. Çdo palë ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera do të mbulohet nga sigurimi, marrëveshje ose ndonjë garanci tjetër siç mund të kërkohet nga shteti i importit ose çdo shteti i cili është Palë.

#### Neni 7

### LËVIZJA NDËRKUFITARE NGA NJË PALË PËRMES SHTETEVE QË NUK JANË PALË

Paragrafi 2 i Nenit 6 të Konventës do t'i detyrohet lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera nga 1 Palë përmes një shteti ose shtetesh që nuk janë Palë.

#### Neni 8

### DETYRIMI I RI-IMPORTIMIT

Kur një lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera për të cilat është dhënë miratimi i shteteve të interesuara, e kushtëzuar prej klauzolave të kësaj Konvente, nuk mund të kryhet plotësisht në përputhje me kushtet e kontratës, shteti i eksportit do të sigurojë që mbetjet në fjalë të kthehen mbrapsht në shtetin e eksportit nga eksportuesi në qoftë se mund të bëhen përgatitje alternative për asgjesimin e tyre në mënyrë që nuk ndikon mbi mjedisin, brenda 90 ditësh që nga koha që shteti importues informoi mbi shtetin e eksportit dhe Sekretariatit, ose çdo periudhë tjetër kohe për të cilën shtetet e interesuara bien dakord. Për këtë qëllim shteti i eksportit dhe çdo Palë e tranzitit nuk do të kundërshtojë, pengojë ose ndalojë kthimin këtyre mbetjeve shtetit të eksportit.

#### Neni 9

### TRAFIKU ILEGAL

1. Për qëllim të kësaj Konvente, ndalohet çdo lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera :

(a) pa njoftimin sipas klauzolave të kësaj Konvente, të të gjitha shteteve të interesuara ose

(b) pa miratimin, sipas klauzolave të kësaj Konvente, të shteteve të interesuara.

(c) me miratimin e marrë prej shteteve të interesuara me anë të fallsfikimit, keqinterpretimit ose mashtrimit.

(d) që nuk përputhet në rrugë materiale me dokumentat

(e) që rezulton në asgjësimin me qëllim (p.sh. dumpingu) të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera në kundërshtim me këtë Konventë dhe me parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

2. Në rastin e një lëvizje ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera që konsiderohen si trafik ilegal si rezultat i trajtimit nga ana e eksportuesit ose prodhuesit, shteti i eksportit duhet të japë siguri që mbetjet në fjalë janë :

(a) marrë mbrapsht prej eksportuesit ose prodhuesit ose në qoftë se është e nevojshme prej atij vetë në shtetin e eksportit ose në qoftë se nuk është e praktikueshme.

(b) për ndryshe ato asgjesohen në përputhje me klauzolat e Konventës, brenda 30 ditëve që nga koha që shteti i eksportit ka qenë informuar për trafikun ilegal ose në një periudhë kohe të tillë që shtetet e interesuara bien dakord. Për këtë qëllim, Palët e interesuara nuk do të kundërshtojnë, pengojnë ose ndalojnë kthimin e këtyre mbetjeve shtetit të eksportit.

3. Në rastin e një lëvizje ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera të konsideruara si trafik ilegal si rezultat i trajtimit nga ana e importuesit ose asgjësuesit, shteti i importit do të sigurojë që mbetjet në fjalë asgjesohen në mënyrë të plotë nga ana mjedisore nga importuesi ose asgjësuesi ose në qoftë se është i nevojshëm nga vetvetja brenda 30 ditëve nga koha që trafiku ilegal është bërë epiqendra e vëmendjes së shtetit të importit ose në një periudhë kohe të tillë që shtetet e interesuara bien dakord. Për këtë qëllim Palët e interesuara do të bashkëpunojnë, sa të jetë e domosdoshme, në asgjësimin e mbetjeve në një mënyrë të plotë dhe efikase për ruajtjen e mjedisit.

4. Në rastet kur përgjegjësia për trafikun ilegal nuk mund të përcaktohet as nga eksportuesi ose prodhuesi e as nga importuesi ose asgjësuesi Palët e interesuara ose Palë të tjera, në mënyrë të përshtatshme, do të sigurojnë përmes bashkëpunimit, që mbetjet në fjalë asgjesohen sa më shpejt që të jetë e mundur në një mënyrë të plotë për ruajtjen e mjedisit, ose në shtetin e eksportit ose me shtetin e importit ose kudo tjetër që të jetë e përshtatshme.

#### Neni 10

### BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin me qëllim që të përmirësojnë dhe të

arrijnë një trajtim të plotë nga ana mjedisore të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.

2. Për këtë qëllim Palët do të :

(a) Në bazë të kërkesës, do të vënë në dispozicion informacionin mbi bazë bilaterale ose multilaterale, me qëllim që të nisin trajtimin e plotë nga ana mjedisore të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, duke përfshirë harmonizimin e standarteve dhe praktikave teknike për trajtimin adekuat të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.

(b) do të bashkëpunojnë në monitorimin e efekteve të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

(c) do të koprojnë të kushtëzuar prej ligjeve, rregullave dhe politikave të tyre kombëtare në zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive të reja me mbetje të ulët dhe përmirësimin e teknologjive ekzistuese me qëllimin e eliminimit, sa të jetë praktikisht e mundur, të prodhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera dhe arritjen e metodave efektive dhe efikase në sigurimin e trajtimit të tyre, në një mënyrë të plotë nga ana mjedisore duke përfshirë studimin e efekteve ekonomike, sociale dhe mjedisore të përshtatjes të teknologjive të tilla të reja dhe të përmirësuara.

(d) do të koprojnë aktivisht, të kushtëzuar prej ligjeve, rregullave dhe politikave të tyre kombëtare në transferimin e teknologjisë dhe sistemeve të trajtimit të lidhura me një trajtim të drejtë nga ana mjedisore e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera. Ato do të koprojnë gjithashtu në zhvillimin e kapacitetit teknik midis Palëve, veçanërisht ato që mund të kenë nevojë dhe kërkojnë asistencë teknike në këtë fushë.

(e) do të koprojnë në zhvillimin e udhëzimeve të duhura teknike dhe kodet e praktikës.

3. Palët do të përdorin mjetet e përshtatshme për të koperuar me qëllim që të ndihmojnë vendet në zhvillim për zbatimin e nënparagrafëve a, b, c. d të paragrafit 2 Neni 4.

4. Duke marrë parasysh nevojat e vendeve në zhvillim kopërimi midis Palëve dhe organizatave kompetente ndërkombëtare do të inkurajohet për të nxitur midis të tjerash, vetëdijen publike mbi zhvillimin e trajtimit të drejtë të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera dhe miratimin e teknologjive të reja me mbetje të ulët.

#### Neni 11

#### MARREVESHJET BILATERALE, MULTILATERALE DHE RAJONALE

1. Pavarësisht nga klauzolat e Nenit 4 paragrafit 5, Palët mund të hyjnë në marrëveshje ose parapërgatitje bilaterale, multilaterale ose rajonale, në lidhje me lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera me Palët dhe Jo-Palët, me kusht që marrëveshje ose parapërgatitje të tilla nuk devijojnë nga trajtimi i plotë nga ana mjedisore i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera siç kërkohet nga kjo Konventë. Këto marrëveshje ose përgatitje do të kushtëzojnë klauzolat të cilat

nuk janë më pak të drejta nga ana mjedisore se sa ato që jepen nga kjo Konventë në veçanti duke marrë parasysh interesat e vendeve në zhvillim

2. Palët do të njoftojnë Sekretariatit për çdo marrëveshje bilaterale, multilaterale ose rajonale siç referohet në paragrafin 1 dhe për ato në të cilat ato kanë hyrje përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, me qëllim që të kontrollojnë lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të cilat ndodhin tërësisht midis Palëve të marrëveshjeve të tilla. Klauzolat e kësaj Konvente nuk do të ndikojnë në lëvizjet ndërkufitare të cilat ndodhen në pajtim me marrëveshje të tilla me kusht që të tilla marrëveshje janë në përputhje me trajtimin e shëndoshë nga ana mjedisore e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera siç kërkohet nga kjo Konventë.

## Neni 12 KONSULTIME MBI PËRGJEGJESINE

Palët do të koprojnë me qëllim që të miratohet sa më praktikisht që të jetë e mundur, një protokoll, i cili do të japë rregullat dhe procedurat e përshtatshme në fushën e përgjegjësisë dhe kompensimit për dëmet që rrjedhin prej lëvizjes ndërkufitare dhe asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.

## Neni 13 TRANSMETIMI I INFORMACIONIT

1. Palët, sa herë ato janë në dijeni do të sigurojnë që në rastin e një aksidenti që ndodh gjatë lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera ose asgjësimit të tyre, të cilat mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisit në shtetet e tjera, këto shtete do të njoftohen menjëherë.

2. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën përmes Sekretariatit për :

(a) ndryshimet në lidhje me caktimin e autoriteteve kompetente dhe pikave fokale në pajtim me Nenin 5.

(b) ndryshimet në përcaktimin e tyre kombëtar të mbetjeve të rrezikshme në pajtim me nenin 3 dhe sa më shpejt të jetë e mundur.

(c) vendimet e bëra prej tyre për të mos miratuar totalisht ose pjesërisht importin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera për asgjësimin brenda zonës nën juridiksionin e tyre kombëtar.

(d) vendimet e marra prej tyre për kufizimin ose ndalimin e eksportit të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera.

(e) çdo informacion tjetër i kërkuar sipas paragrafit të këtij neni.

3. Palët, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare do të transmetojnë përmes Sekretariatit, Konferencës së Palëve të vendosura në Nenin 15, përpara fundit të secilit vit kalendarik, një raport mbi vitin e kaluar kalendarik, i cili përmban informacionin e mëposhtëm

(a) autoritetet kompetente dhe pikat fokale që janë emëruar prej tyre në pajtim me Nenin 5.

(b) informacion në lidhje me lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera në të cilat ato janë inkluduar, duke përfshirë:

(i) sasinë e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të eksportuara, kategorinë, karakteristikat, destinacionin e tyre, çdo vend tranzit dhe metodë asgjësimi siç paraqitet në përgjigjen ndaj njoftimit.

(ii) sasia e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të importuara, kategoria, karakteristikat, origjina e tyre dhe metodat e asgjësimit.

(iii) përpjekjet për arritjen e pakësimit të sasisë së mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera që i nënshtrohen lëvizjes ndërkufitare.

(c) informacion mbi masat e miratuara prej tyre për zbatimin e kësaj Konvente.

(d) informacionin mbi statistikat e nevojshme dhe të kualifikuara të cilat janë përpiluar prej tyre në lidhje me efektet mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisit e prodhimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera.

(e) informacion në lidhje me marrëveshjet dhe përgatitjet bilaterale dhe multilaterale dhe rajonale që kanë hyrë në përputhje me Nenin 11 të kësaj Konvente.

(f) informacion në lidhje me aksidentet që ndodhin gjatë lëvizjes ndërkufitare dhe asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera dhe mbi masat e ndërmarra për trajtimin e tyre.

(g) informacion mbi variantet e asgjësimit të zbatuara brenda zonës së juridiksionit të tyre kombëtar.

(h) informacion mbi masat e marra për zhvillimin e teknologjive për pakësimin dhe/ose eliminimin e prodhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, dhe

(i) çështje të tilla që Konferenca e Palëve do t'i konsiderojë si të lidhura me çështjen në fjalë.

4. Palët në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare do të sigurojnë që kopjet e secilit njoftim në lidhje me çdo lëvizje të dhënë ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera dhe përgjegjësia ndaj tij, i janë dërguar Sekretariatit kur një Palë e cila mendon që mjedisi i saj mund të infektohet nga kjo lëvizje ndërkufitare, ka kërkuar që kjo duhet bërë.

1. Palët bien dakord që në përputhje me nevojat specifike të rajoneve dhe nenrajoneve të ndryshme, duhet të ngrihen qendra rajonale dhe nënrajonale për kualifikimin dhe transferimin e teknologjive në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera dhe minimizimin e prodhimit të tyre. Palët duhet të vendosin mbi ngritjen e mekanizmave të përshtatshme të fondeve, në mënyrë vullnetare.

2. Palët do të shqyrtojnë krijimin e një fondi qarkullimi për të ndihmuar, mbi një bazë të përkohshme, në rast situatash emergjente për të minimizuar dëmet nga aksidentet që lindin prej lëvizjeve ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera ose gjatë asgjësimit të këtyre mbetjeve.

## Neni 15 KONFERENCA E PALËVE

1. Një Konferencë e Palëve tashmë është vendosur. Mbledhja e parë e saj do të thirret nga Drejtori Ekzekutiv i UNEP-it jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Pas kësaj, mbledhjet e zakonshme të Konferencës së Palëve do të mbahen në intervale të rregullta, që do të përcaktohen nga Konferenca në mbledhjen e saj të parë.

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve do të mbahen në kohë të tjera të tilla siç mund të konsiderohet e nevojshme prej Konferencës ose në bazë të kërkesës me shkrim të çdo Palë, me kusht që brenda 6 muajve nga komunikimi i kërkesës Sekretariatit, ajo të përkrahet nga të paktën 1/3 e Palëve.

3. Konferenca e Palëve me konsensus do të bjerë dakord dhe miratojë rregullat e procedurës për vetveten dhe për çdo organ të varur që ajo mund të krijojë si dhe rregullat financiare për përcaktimin në veçanti të pjesëmarrjes financiare të Palëve të Konventës.

4. Palët në mbledhjen e tyre të parë do të shqyrtojnë çdo mase suplementare të nevojshme për t'i ndihmuar ato në plotësimin e përgjegjësisë të tyre përsa i përket mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit detar në kontekstin e kësaj Konvente.

5. Konferenca e Palëve do të mbajë nën shqyrtim dhe vlerësim të vazhdueshëm zbatimin efektiv të kësaj Konvente dhe për më tepër:

(a) do të nxisë harmonizimin e politikave, strategjive dhe masave të duhura për minimizimin e dëmeve të shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera.

(b) do të shqyrtojë dhe miratojë, siç kërkohkërkot, amendamentet e kësaj Konvente dhe shtojcave të saj duke marrë parasysh midis të tjerash informacionin e disponueshëm shkencor, teknik, ekonomik dhe mjedisor.

(c) do të shqyrtojë dhe ndërmarrë çdo veprim suplementar që mund të kërkohet për arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente në dritën e eksperiencës së fituar në veprimtarinë e saj dhe të marrëveshjeve dhe përgatitjeve të parashikuara në nenin 11.



(d) do të shqyrtojë dhe miratojë protokollet e kërkuara.

(e) do të krijojë organe të tilla ndihmëse që konsiderohen të nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente.

6. Kombet e Bashkuara, agjencitë e tyre të specializuara si edhe çdo shtet jo Palë i kësaj Konvente mund të përfaqësohen nga vëzhgues në mbledhjet e Konferencës së Palëve. Çdo organ ose agjenci tjetër kombëtare ose ndërkombëtare, qeveritare ose jo qeveritare e kualifikuar në fushat që kanë lidhje me mbetjet e rrezikshme ose mbetjet e tjera, i cili ka informuar Sekretariatit për dëshirën e tij për t'u përfaqësuar si vëzhgues në një mbledhje të Konferencës mund të pranohet në qoftë së të paktën 1/3 e Palëve pjesëmarrëse nuk është kundër. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do t'i nënshtrohet rregullave të procedimit të miratuar nga Konferenca e Palëve.

7. Konferenca e Palëve do të ndermarrë 3 vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe të paktën 6 vjet pas saj, një vlerësim të efektivitetit të saj dhe në qoftë se konsiderohet e nevojshme do të shqyrtojë miratimin e ndalimit të plotë ose të pjesshëm të lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera në dritën e informacionit të fundit shkencor, mjedisor, teknik dhe ekonomik.

## Neni 16 SEKRETARIATI

1. Funkcionet e Sekretariatit do të jenë:

(a) të bëjë përgatitjet dhe t'u shërbejë mbledhjeve sipas neneve 15 dhe 17.

(b) të përgatisë dhe të transmetojë raporte të bazuara mbi informacionin e marrë në përputhje me nenet 3, 4, 6, 11 dhe 13 sikurse dhe informacionin e marrë nga mbledhjet ndihmëse të vendosura në nenin 15, si edhe mbi informacionin prej organeve përkatëse qeveritare dhe jo qeveritare.

(c) të përgatisë raporte mbi aktivitetet e tij të zhvilluar në zbatim të funksioneve të tij sipas Konventës dhe t'ia paraqesë ato Konferencës së Palëve.

(d) të sigurojë kordinimin e nevojshëm me organet përkatëse ndërkombëtare dhe në veçanti të hyjë në marrëveshje të tilla administrative dhe kontraktore siç mund të kërkohet për kryerjen efektive të funksioneve të tij.

(e) të komunikojë me pikat fokale dhe autoritetet kompetente të krijuara nga Palët në përputhje me Nenin 5 të kësaj Konvente.

(f) të përpilojë informacionin në lidhje me vendet e autorizuara dhe shërbimet kombëtare të Palëve të cilat disponohen për asgjesimin e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të tyre dhe ta qarkullojë këtë informacion midis Palëve.

(g) të marrë prej dhe t'u transmetojë Palëve informacion, mbi :

- burimet e asistencës dhe kualifikimit

- ekspertizen teknike dhe shkencore që disponohet
- burimet e kërkimit dhe ekspertizës
- disponimin e burimeve financiare

me qëllim që t'i ndihmojë ata, sipas kërkesës, në zona të tilla si:

- trajtimi i sistemit të njoftimit të kësaj Konvente
- trajtimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera
- teknologjitë në pajtim me mjedisin në lidhje me mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera të tilla si teknologji më pak ose aspak mbetje
- vlerësimi i kapaciteteve dhe vendeve të asgjësimit
- monitorimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera
- përgjigjet e emergjencës

(h) T'u japë Palëve, në bazë të kërkesës, informacionin mbi konsulentët ose firmat konsultative që kanë kompetencën e nevojshme teknike në këtë fushe, i cili mund t'i ndihmojë ato në shqyrtimin e njoftimit për një lëvizje ndërkufitare, ngarkimin e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera me njoftimin përkatës dhe/ose fakti që impiantet e propozuara të asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera janë në pajtim me mjedisin kur ato kanë arsye për të besuar që mbetjet në fjalë nuk do të trajtohen në një mënyrë të duhur mjedisore. Çdo ekzaminim i tillë nuk do të jetë në dëm të Sekretariatit.

(i) të ndihmojë Palët me kërkesë të tyre, në identifikimin prej tyre të rasteve të trafikut dhe tu qarkullojë menjëherë palëve të interesuara çdo informacion që ai ka marrë në lidhje me trafikun ilegal.

(f) të koprojë me Palë dhe organizatat e agjencitë kompetente ndërkombëtare në dhënien e ekspertëve dhe paisjeve për një asistencë të shpejtë shteteve në rastin e një situatë emergjence.

(g) të kryejë funksionet të tjera të tilla që kanë të bëjnë me qëllimet e kësaj Konvente siç mund të përcaktohet nga Konferenca e Palëve.

2. Funksionet e Sekretariatit do të kryhen përkohësisht nga UNEP-i deri në përfundimin e mbledhjes së parë të Konferencës së Palëve e mbajtur në pajtim me Nenin 15.

3. Në mbledhjen e saj të parë, Konferenca e Palëve do të zgjedhë Sekretariatin prej atyre organizatave ekzistuese kompetente ndërqeveritare të cilat kanë bërë të njohur dëshirën e tyre për të kryer funksionet e Sekretariatit në këtë Konventë. Në këtë mbledhje Konferenca e Palëve do të vlerësojë gjithashtu zbatimin prej Sekretariatit të përkohshëm të funksioneve që u janë caktuar atij, në veçanti sipas paragrafit 1 më sipër dhe do të vendosë mbi strukturat e përshtatshme për këto funksione.

## Neni 17 AMENDAMENTI I KONVENTES

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamentet e kësaj Konvente dhe çdo Palë në

një protokoll mund të propozojë amendamentet për këtë protokoll. Amendamentet e tilla do të marrin mirë parasysh, midis të tjerash, konsideratat përkatëse shkencore dhe teknike.

2. Amendamentet e kësaj Konvente do të miratohen në një mbledhje të Konferencës së Palëve. Amendamentet e çdo protokollit do të miratohen në një mbledhje të Palëve për protokollin në fjalë. Teksti i çdo amendamenti të propozuar për këtë Konventë ose çdo protokoll me përjashtim kur nuk thuhet ndryshe në një protokoll të tillë, do tju komunikohet Palëve nga Sekretariati së paku 6 muaj përpara mbledhjes në të cilën ai është propozuar për miratim Sekretariati gjithashtu do të komunikojë amendamentet e propozuara, nënshkruesve të Kësaj Konvente për informacion.

3. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje mbi çdo amendament të propozuar në këtë Konventë me konsensus. Në qoftë se gjitha përpjekjet për konsensus shterojnë dhe nuk arrihet asnjë marrëveshje, amendamenti do të miratohet, si mjet i fundit, nga 3/4 e shumicës së Palëve të pranishme me votim dhe do t'u paraqitet të gjitha Palëve nga Sekretariati për miratim, aprovim konfirmim ose pranim formal.

4. Proçedura e përmendur në paragrafin 3 me sipër do t'u referohet amendamenteve të çdo protokoll me përjashtim që 2/3 e shumicës së Palëve të këtij protokollit të pranishme dhe që votojnë në mbledhje do të mjaftojnë për miratimin e tyre.

5. Dokumentet e ratifikimit, aprovimit, konfirmimit ose pranimit formal të amendamenteve do të depozitohen në Sekretari. Amendamentet e miratuara, në përputhje me paragrafët 3 ose 4 me sipër do të hyjnë në fuqi mes Palëve pasi t'i kenë pranuar ato në ditën e 90 pas marrjes prej Sekretariatit të dokumentit të miratimit, aprovimit, konfirmimit, ose pranimit formal të paktën prej 3/4 e palëve që pranuan amendamentet ose të paktën nga 2/3 e Palëve me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në një protokoll të tillë. Amendamentet e pranuar prej tyre do të hyjnë në fuqi për çdo Palë tjetër në ditën e 90 pasi kjo Palë depoziton dokumentat e aprovimit, miratimit, konfirmimit ose pranimit formal të amendamenteve.

6. Për qëllim të këtij neni "Palët e pranishme dhe votuese " d.m.th. palët që janë të pranishme dhe që japin votën pro ose kundër.

#### Neni 18

#### MIRATIMI DHE PËRMIRRESIMI I SHTOJCAVE

1 Shtojcat e kësaj Konvente ose të çdo protokollit do të formojnë një pjesë integrale të kësaj Konvente ose të një protokollit të tillë sipas rastit dhe në qoftë se nuk jepet shprehimisht ndryshe, reference e kësaj Konvente ose protokolleve të saj përbën në të njëjtën kohë një reference për çdo shtojcë. Shtojca të tilla do të kufizohen në çështje shkencore, teknike dhe administrative.

2. Përveç rastit kur mund të jepet ndryshe në çdo protokoll në lidhje me shtojcat e saj, procedurë e mëposhtme do t'i referohet propozimit, miratimit dhe hyrjes në fuqi të shtojcave të tjera për këtë Konventë ose shtojcave të një protokollit.

(a) shtojcat e kësaj Konvente dhe protokollet e saj do të propozohen dhe miratohen në bazë të procedurës së parashtruar në nenin 17, të paragrafit 2, 3, 4.

(b) Çdo palë që nuk është në gjendje të pranojë një shtojcë suplementare për këtë Konvente ose një shtojcë për çdo protokoll palë e së cilës është do njoftojë me shkrim, Sekretarinë brenda 6 muajve nga data e komunikimit të miratimit prej Sekretarisë. Sekretaria do të njoftojë pa vonesë të gjitha Palët për çdo njoftim të tillë të marrë. Një Palë në çdo kohë mund të pranojë një deklaratë të mëparshme të kundërshtuar dhe shtojcat pas kësaj do të hyjnë në fuqi për atë Palë.

(c) Me mbarimin e afatit të 6 muajve prej datës së qarkullimit të komunikimit nga Sekretaria, shtojca do të bëhet efektive për të gjitha palët e kësaj Konvente ose të çdo protokollit të lidhur me të, e cila nuk ka paraqitur një njoftim në përputhje me klauzolën e nënparagrafit (b) me sipër.

3. Propozimi miratimi dhe hyrja në fuqi e amendamenteve, shtojcave të kësaj Konvente ose të çdo protokollit do t'i nënshtrohen të njëjtës procedurë si për propozimin, miratimin dhe hyrjen në fuqi të shtojcave për Konventën dhe shtojcave për një protokoll. Shtojcat dhe amendamentet për më tepër do t'i kushtojnë vëmendjen e duhur, midis të tjerave konsideratave përkatëse shkencore dhe teknike.

4. Në qoftë se një shtojcë suplementare ose një amendament i një shtojce përfshin një amendament të kësaj Konvente ose të ndonjë protokollit, shtojca suplementare ose e përmirësuar nuk do të hyjë në fuqi deri në një kohë të tillë kur amendamenti i kësaj Konvente ose protokollit hyn në fuqi.

#### Neni 19 VERIFIKIMI

Çdo Palë e cila ka arsye të besojë që Pala tjetër po vepron ose ka vepruar në kundërshtim me detyrimet e saj në këtë Konvente mund të informojë Sekretariatit për këtë, dhe në një rast të tillë do të informojë menjëherë dhe në të njëjtën kohë, direkt ose përmes Sekretariatit, palën kundër së cilës janë ngritur pretendimet. I gjithë informacioni përkatës do t'u paraqitet Palëve nga Sekretariati.

#### Neni 20 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Në rastin e një mosmarrëveshje midis Palëve në lidhje me interpretimin ose aplikimin ose zbatimin e kësaj Konvente ose me çdo protokoll të saj ato do të kërkojnë një zgjidhje të mosmarrëveshjes përmes bisedimeve ose ndonjë mjeti tjetër paqësor të zgjedhur prej tyre.

2. Në qoftë se Palët e interesuara nuk mund të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me anë të mjeteve të përmendura në paragrafin e mësipërm, mosmarrëveshja, në qoftë se bien dakord Palët e mosmarrëveshjes, do t'i paraqitet gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë ose arbitrazbit sipas kushteve të parashtruara në Shtojcën VI mbi Arbitrazhin. Sidoqoftë, dështimi në arritjen e një marrëveshje të përbashkët mbi paraqitjen e mosmarrëveshjeve gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë ose arbitrazhit nuk

do t'i shkarkojnë Palët nga përgjegjësia e vazhdimit të kërkimit të zgjidhjes së saj me mjetet e referuara në paragrafin 1.

3. Gjatë miratimit, pranimit, aprovimit, konfirmimit formal të kësaj Konventë ose çdo kohe pas tij, një shtet dhe/ose organizatë e integritit politik, ekonomik mund të deklarojë që ai e njeh si të detyrueshme pikërisht nga ky fakt dhe pa marrëveshje të veçantë në lidhje me çdo Palë që pranon detyrimin e njëjtë :

(a) paraqitjen e mosmarrëveshjes gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë, dhe/ose

(b) arbitrimin në përputhje me procedurat e parashtruara në shtojcën VI. Rreth një deklarate të tillë do të njoftohet me shkrim Sekretariati i cili do t'ia komunikojë atë Palëve.

#### Neni 21 NENSHKRIMI

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim prej Shteteve, Namibisë të përfaqësuar nga Këshilli i Evropës për Namibinë dhe/ose nga organizatat e integritit ekonomik përkatës në Bazel më 22 Mars 1989 në Departamentin Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës në Bernë nga 23 Mars deri më 30 Qershor 1989 dhe në Qendrat e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork nga 1 Korrik 1989 deri me 22 Mars 1990.

#### Neni 22 MIRATIMI, PRANIMI, KONFIRMIMI DHE APROVIMI FORMAL

1. Kjo Konventë do t'i nënshtrohet miratimit, pranimit prej Shteteve, të Namibisë të përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë si edhe konfirmimit ose aprovimit nga organizatat e integritit politik dhe ekonomik. Instrumentet e miratimit, pranimit, konfirmimit ose aprovimit formal do të depozitohen në Sekretari.

2. Çdo organizatë që përmendet në paragrafin 1 më sipër e cila bëhet Palë në këtë Konventë në rastin kur asnjë nga shtetet anëtare nuk është Palë, duhet të zbatojë të gjitha detyrimet në këtë Konventë. Në rastin e organizatave të tilla kur një ose më shumë shtete anëtare janë Palë në Konventë, organizata dhe Shtetet anëtare të saj do të vendosin mbi përgjegjësitë e tyre respektive për kryerjen e detyrimeve të tyre në këtë Konventë. Në raste të tilla, organizata dhe Shtetet anëtare nuk do të autorizohen të ushtrojnë të drejtat në këtë Konventë.

3. Në dokumentat e konfirmimit dhe aprovimit formal, organizatat që përmenden në paragrafin 1 më sipër do të deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet e udhëhequra nga Konventa. Këto organizata do të informojnë Sekretarinë e cila do të informojë Palët për çdo modifikim suplementar në zgjerimin e kompetencave të tyre.

#### Neni 23 SUGJERIME SHTESE

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për sugjerime nga Shtetet, nga Namibia e

përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë dhe nga organizatat e integritit politik dhe ekonomik që nga dita pas datës në të cilën Konventa mbyllet për nënshkrim. Dokumentat e sugjerimeve shtesë do të depozitohen në Sekretari.

2. Në dokumentat e hyrjes në fuqi organizatat e përmendura në paragrafin 1 më lart do të deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet e udhëhequra nga Konventa. Këto organizata do të informojnë gjithashtu Sekretarinë për çdo modifikim mbi shtrirjen e kompetencës së tyre.

3. Klauzolat e Nenit 22 paragrafi 2, do t'i referohen organizatave të integritit politiko- ekonomik, të cilat janë dakord me këtë Konventë.

#### Neni 24 E DREJTA E VOTES

1. Përveç asaj që jepet në paragrafin 2 më poshtë, çdo Palë kontraktuese në këtë Konventë do të ketë një votë.

2. Organizatat politike dhe/ose organizatat e integritit politiko-ekonomik, në çështjet brenda kompetencave të tyre në përputhje me Nenin 22 paragrafi 3 dhe Nenin 23 paragrafi 2, do të ushtrojnë të drejtën e votës me një numër votash të barabarta me numrin e Shteteve anëtare që janë Palë në Konventë ose në protokollin përkatës. Këto organizata nuk do të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në qoftë se Shtetet e tyre anëtare ushtrojnë të tyren ose anasjelltas.

#### Neni 25 HYRJA NE FUQI

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e 90 pas datës së depozitimit të dokumentit të 20 të miratimit, pranimit, konfirmimit, aprovimit ose shtesave formale.

2. Për çdo shtet ose organizate të integritit ekonomiko-politik, i cili miraton, pranon, aprovon ose konfirmon formalisht këtë Konventë ose pranon atë pas datës së depozitimit të dokumentit të 20 të miratimit, pranimit, aprovimit, konfirmimit formal ajo do të hyjë në fuqi në ditën e 90 pas datës së depozitimit prej një Shteti të tillë ose organizate të integritit ekonomiko- politik të dokumentit të tij të miratimit, pranimit, aprovimit ose konfirmimit formal.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 më sipër çdo dokument i depozituar nga një organizatë e integritit politiko-ekonomik do të konsiderohet si dokument suplementar i atyre të depozituara nga Shtetet anëtare të kësaj organizate.

#### Neni 26 REZERVIMET DHE DEKLARATAT

1. Asnjë rezervim ose përjashtim nuk mund t'i bëhet kësaj Konvente.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk e pengon një Shtet ose organizate e integritit

politiko dhe/ose ekonomik që gjatë nënshkrimit, miratimit, pranimit, aprovimit, konfirmimit ose pranimit formalisht të kësaj Konventë të bëjë, midis të tjerave, deklarata ose përcaktime, pavarësisht nga formulimi ose emërimi për harmonizim e ligjeve dhe rregullave të tij në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente, me kusht që deklaratat e tilla nuk nënkuptojnë përjashtim ose modifikimin e efekteve ligjore të klauzolave të Konventës në aplikimin e tyre për atë Shtet.

Neni 27  
REFUZIMI, TERHEQJA

1. Në çdo kohë pas 3 vjetësh nga data në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi për një Palë, kjo Palë mund të tërhiqet nga Konventa duke i dhënë njoftim me shkrim Sekretarisë.
2. Refuzimi do të jetë efektiv një vit nga marrja e njoftimit prej Sekretarisë ose në një datë të tillë të mëvonshme siç mund të specifikohet në njoftim

Neni 28  
SEKRETARIA

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë Sekretaria e kësaj Konvente ose çdo protokolli të saj.

Neni 29  
TEKSTET AUTENTIKE

Tekstet origjinale në arabisht, anglisht, frengjisht, rusisht, spanjisht dhe në gjuhën kineze të kësaj Konvente janë në mënyrë të barabartë autentike.

DESHMITARET TË ATYRE QË nënshkruajnë më poshtë dhe të autorizuar si më të përshtatshëm kanë nënshkruar në këtë Konventë.